



Alkooli / duhani / droga

Kush mban drogë, e konsumon apo e shet, e bënë veten të dënohet.
Për shitje të alkoolit dhe duhanit ka kufizim në moshë.

Droga

Mbajtja, shitja apo konsumimi ilegal i drogës është i dënueshëm. Kjo vlen edhe për sasi të vogla. Cilat substanca janë ilegale, është e rregulluar me ligjin për mjete narkotike (Betäubungsmittelgesetz | loi sur les stupéfiants). Shitja e drogës për përfitime personale ndëshkohet me dënime të larta.

Alkooli dhe duhani

Për shitjen e alkoolit dhe duhanit ka kufizim të moshës. Kështu duhani dhe pijet alkoolike në kantonin e Bernit nuk guxojnë tu shiten të rinjëve nën 16 vjeç. Për pije alkoolike të posaçme si spirituset, kufiri në moshë qëndron te 18 vjeç. Kush ju jep të rinjve alkoool apo duhan mund të dënohet. Personeli i restorantve dhe i shitoreve duhet ta vërtetoj moshën e vizitorëve gjegjësisht të blersëve.

Ndalimi i pirjes të duhanit

Ndalimi i pirjes të duhanit në Zvicër është kantonalisht ndryshueshëm i rregulluar. Në kantonin e Bernit vlen ndalimi i duhanit në hapësirat e mbyllura, në hapësirat e hapura të frekuentuara (Spitalet, administratat, shkollat, muset, kino, teatri, treni, autobusat, shitoret, dhe qendrat për blerje). Pirja e duhanit është e ndaluar edhe mbrenda në restorant. Përjashtim bëjnë dhomat për pirjen e duhanit, të cilat janë të ndara dhe të ajrosura, mirëpo secilën herë ka më pak. Ndalimi i pirjes të duhanit do të duhej ta mbronte shëndetin njerëzve.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/mire-me-dit/alkooli--duhani--droga